



Nr. 845 Prot.

Prishtinë, më 13 / 4 / 2023

Nr. 165 Prot.

Tiranë, më 13 / 04 / 2023

ANEKS

i

Marrëveshjes për bashkëpunim në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor

ndërmjet

Universitetit të Prishtinës

dhe

Akademisë së Studimeve Albanologjike

Transmetimi i dijes tek brezat e rinj, në fushat e Albanologjisë, duhet të shndërrohen në një strategji për të dy institucionet tona UP dhe ASA, me qëllim edhe përditësimin dhe pasurimin me teza të reja të dijes albanologjike. ASA shikon tek UP, partnerin kryesor për zhvillimin e dijes së avancuar në lëmejtë e albanologjisë si në Kosovë dhe në Shqipëri.

Akademia e Studimeve Albanologjike propozon pikat e mëposhtme si një aneks të marrëveshjes me Universitetin e Prishtinës.

1. Krijimin e grupeve të punës për hartimin e projekteve strategjike të përbashkëta në fushën e albanologjisë – përkatësisht në fushën e arkeologjisë, antropologjisë social-kulturore, historisë dhe gjuhësisë.
2. Ndërtimin e programeve të përbashkëta në studimet Master dhe Doktoraturë në fushën e albanologjisë – arkeologji, antropologji social-kulturore, histori, gjuhësisë.
3. Krijimin e një platforme të përbashkët për shkëmbimin e stafit akademik në mes dy institucioneve.
4. Hulumtime të përbashkëta për trashëgiminë kulturore në Kosovë dhe Shqipëri.

Ky aneks do të respektojë marrëveshjet ndërqeveritare Kosovë-Shqipëri, lidhur me fushën e arsimit dhe trashëgimisë kulturore të secilit vend, si dhe aktet rregullatore [statute, rregullore, strategji të secilit institucion].

Për

Universitetin e Prishtinës

REKTORI



Prof. dr. Qerim Qerimi

The seal of the University of Prishtina is circular, featuring a sunburst in the center. The text around the border reads "UNIVERSITETI I PRISHTINËS 'HASAN PRISHTINA'" and "UNIVERSITY OF PRISHTINA". The year "1970" is at the bottom.

Për

Akademisë e Studimeve
Albanologjike

REKTORI



Prof. dr. Luan Përzhita

The seal of the Albanological Studies Academy is circular, featuring a double-headed eagle in the center. The text around the border reads "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" and "AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE". The word "TIRANË" is at the bottom.